

Ambasadorët e Paqes

Gjallërohen në takimin e Korçës

Raporti nga Sokol Rexhepi

Pas takimit të tyre të parë, Këshilli i sapozgjedhur Rajonal i Paqes Korçë, vendosi të zgjerojë rrjetin e ApP në këtë rajon duke caktuar Ambasadorë të rinj për Paqen, si nga mosha ashtu dhe nga angazhimi në FPU; me qëllim që të kapin siç duhet vizionin e FPU-se dhe Prindërve të Vërtetë dhe të rigjallëronin Këshillin e Paqes Korçë. Përfundimisht u arrit të vendosej për një aktivitet gjysmë ditor në datën 10 prill.



Kjo do të ishte në formën e një konference të shkurtër rajonale të lidershit, me të ftuar këshillin ekzistues dhe kandidatët e rinj që do të emëroheshin si Ambasadorë për Paqen. Zyra qendrore në Tiranë mundësoi gjithë mbështetjen teknike për koordinatorin lokal, të ri por efektiv, Ermir Hoxha, i cili po lëvizte për të ftuar njerëzit dhe për të bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme praktike.



Si përfundim, z. Ali Lacej, kryetar i Bordit Drejtues të FPU-së dhe Sokol Rexhepi, nga zyra qendrore FPU, u nisën nga Tirana si lektorë dhe bashkorganizues të të aktivitetit, i cili u mbajt në hotelin kryesor në qendër të qytetit. Salla e vogël por simpatike filloi të mbushej në mënyrë konstante nga të ftuarit që u

mirëpritën nga kryetari lokal i FPU-së, z. Kotmilo, një mik i yni dhe një njeri me shumë influencë në Korçë.

Rreth orës 15.30 z. Lacey, prezantoi në mënyrë të hollësishme pesë parimet e paqes së FPU-së, të ilustruara nga një prezantim i pasur në Poëer Point. Ai u mirëprit për rreth 60 minutat ku foli me mjaft elokuencë dhe ëmbëlси. Ne ndihemi vërtet me fat që kemi një ApP të tillë që të prezantojë kaq bukur parimet e FPU-së, vecanërisht dikë si ish-prefekti i Shkodrës, i cili ende është me shumë ndikim në qytetin e tij.



Pas një pushimi të nevojshëm, të gjithë u kthyen për seancën e fundit, e cila u moderua nga znj. Marinela Stefanc, që erdhi më vonë nga Tirana. Pas një video prezantimi mbi misionin dhe punën e ApP të rregulluar në shqip nga Mateo Ziko, z.Rexhepi prezantoi misionin, vizionin dhe aktivitetet kryesore të FPU në nivel botëror dhe kombëtar. Menjëherë pas kësaj ishte ceremonia e emërimit të ApP ku shtatë persona, shumica me ekperiencë në fushën juridike, morën certifikatën dhe ndanë me pjesën tjetër emocionet e rastit.



mpirtërisht... FPU/FFPB... të ftuarit... ishte krijuar... i. Ne shpresojmë vërtet se ky aktivitet do të shënoje një fillim të ri për keshillin rajonal të paqes Korçë dhe do

të kontribuojë në përhapjen e mëtejshme të mesazhit të PV. Në fund do të doja të përgëzoja anëtarët e Korçës, të cilët investuan me shumë sukses për këtë aktivitet.

